BANKA KOMBËTARE E SHQIPNIS

ZYRA E STUDIMEVE

PERMBLEDHJE e Çështjeve Kryesore Ekonomike dhe Financiare të Shqipnis

KATËRVJETOR PRIELL 1939 MARS 1943

TIRANË - DHJETOR 1943

BKSH

BKSH

BANKA KOMBËTARE E SHQIPNIS

ZYRA E STUDIMEVE

PERMBLEDHJE

E

Çështjeve Kryesore Ekonomike

DHE

Financiare të Shqipnis

KATËRVJETOR PRILL 1939 MARS 1943

TIRANË - DHJETOR 1943

BKSH

BKSH

BKSH

B.K.S.
SHQIPNIA
DETI ADRIATIK
I. CORFÙ
LEGJENDË
Kufit e shtetit.
Kufit e prefektura.
Prefektura.
Rrugë kryesore.
Rrugë të dyta.
SHKALLA 1: 1.500.000
KILOMETRA
Tirana
Durrësi
Shkodra
Kukës
Prizren
Pec
Prishtine
Peshkopia
Debar
Ohrid
Elbasan
Berat
Vlorë
Korça
Gjirokastra

BKSH

BKSH

BKSH

VEPRIMTARI' EKONOMIKE DHE INDUSTRIALE

oooOooo

Veprimtaria ekonomike shqipëtare që në Tetor 1940 premtonte një shvillim lulëzonjës, nuk ka mundur më, prej kësaj kohe, të shvillohet rregullisht simbas shtytjes që i ësht dhënë nga gjendja e rè e punëve, së pari për shkak të luftës dhe pastaj nga kondidat ekonomike - politike të jashtëzakonëshme. Ndërsa këto të fundit kanë ushtruar influencën e tyre në sektorin tregëtar, lufta e bërë në tokën shqipëtare ka pasur reperkusionet e saja të dëmëshme veçanërisht në veprimtarinë prodhonjëse.-

Me gjithë këtë shvillimi i ekonomisë shqipëtare nuk ka qënë aspak negativ dhe, përkundrazi, duhet të pohojmë se ekonomia shqipëtare ka ecur shpejt duke përparuar gati në të gjithë sektorët.-

Në Bujqësì (lidhja A.), ndërsa më 1940 prodhimet, në krahasim me vjetët e fundit, kanë qënë përgjithësisht të pa-kënaqëshëm, më 1941 (megjithëse në luftë me Greqinë) dhe më 1942 (megjithëse një mesatare t'ulët) kemi pasur prodhime bujqësore shum'a pak të mira. Në vjetin vazhdues këto prodhime - megjithse mungojnë shënimet zyrtare mbi vleftën e tyre të vërtetë - mund të çmohen të paktën 20% më shumë nga ato të 1942. Natyrisht duke marë parasysh vështirësitë e trasporteve, ësht për t'u parashikuar se këtë vjet prodhimet nuk do të munden të shpërndahen në krahinat e ndryshme simbas nevojave të tyre.-

Teknika bujqësore dhe bujqësia po përparojnë dhe kjo gjë duhet të na japë shpresa për t'arthmen.

Prodhimi i lëkurave ka qënë gjithashtu i favorshëm në këta vjete ndërsa kanë qënë të rregullta edhe prodhimet e leshit e të djathit.-

Në sektorin industrial (lidhja B.) vëndi ësht pasuruar gradualisht me shoqërinat sipërmarëse të krijuara me sisteme dhe kritere moderne, qoftë edhe në madhësira të kufizuara sikurse, nga ana tjetër, kërkohet prej nevojavet të vëndit.

Megjithse periudha 1939/1943 duhet të quhet si organizuese dhe reorganizuese, e prandaj, për vetë natyrën e saj, jo shumë e pasur në fitime, nuk mund të mohohet që industria shqipëtare ka bërë, në çdo sektor, një përparim të rëndësishëm, me gjithë vështirësitë e rjedhura nga çmimi i lartë i trasporteve të lëndëve të para dhe i punëtorisë.

Duke lënë më nj'anë shoqëritë sipërmarëse për ndërtime banesash e rrugash si dhe ato të autotrasporteve - për të cilat nuk kemi ènde komunikime zyrtare mbi numurin dhe mbi përbërjen e tyre por që, siç ësht e ditur, janë të shumta dhe pushtojnë një kontigjent të mirë punëtorësh-të

./...

BKSH

tjerat (me përjashtim të atyreve që kanë karakter thjesht zejtar) u japin punë më se 10.000.- vetave, duke përfshirë në këtë numur edhe familjet e bujqëvet t'industrive të mbëdha bujqësore.

Inisjativat e shumta të filluara me realizime të shpejta, numuri i industrive që veprojnë prej kohe dhe energjia e installuar do të munden të lejojnë në t'ardhmen një prodhim më të madh dhe përdorimin e grupeve të tjerë zejtarësh.

Duke u bazuar mbi sa u parashtrua më lart, mund të përfundojmë se industria shqipëtare do të mundet më vonë të shvillohet dhe të sigurohet në qoftë se do të ketë parasysh që:

a) duhen kufizuar shpenzimet e prodhimit në mënyrë që prodhimi lokal të mos ketë frikë nga konkurrenca e huaj;

b) për funksjonimin e makinave të punimit duhen përdorur materiale (lëndë të djegëshme) të prodhimit të vëndit (linjite,qymyr,metan.).-

c) duhen kufizuar shpenzimet e trasportit.

<u>Industria e minierave</u>, baza e industrisë shqipëtare, esht forcuar e përcaktuar edhe më, në vazhdim të bashkimit të tokave të liruara,ku ka gjetur një fushë të gjerë, çelur veprimtarisë së saj, dhe ka filluar me një herë të punojë. Për tani ka përfituar në mënyrë të veçantë sektori i kromit (40.000.- ton. në vjet).

Pasuritë minerare të Shqipërisë (simbas llogarive të kujdesëshme, të vetmet shtresa të mineraleve të hekurit janë llogaritur në më shumë se 20.000.000.- tonellata) përbëjnë një pikë nisjeje nga e cila mund të dalë krejt një makinari industriale për t'u dhënë, më një herë në vënd, të paktën një punim të parë lëndëve të para për t'evituar një dyfishim të shpenzimeve të trasporteve, kaq mbi lëndët e para deri në qendrën e punimit, sa edhe mbi prodhimin e mbaruar deri në vëndin e konsumit.

<u>Punët botore</u> kanë qënë ato që i kanë ndjerë më shumë rrethanat e jashtëzakonëshme dhe kanë qënë penguar nga vështirësitë dhe pamundësitë e furnizimit të materialeve.

Disa punime kanë qënë pezulluar dhe disa të tjera kanë qënë vazhduar me ritme të ngadalësuar.

Në këto kohët e fundit janë shtuar, përkundrazi, në mënyrë të veçantë punimet e ngrehjes së banesave për llogari të privatëve.

<u>Tregëtia e mbrendëshme</u> ka qënë për disa kohë shumë aktive duke shpërndarë në viset e ndryshme mallërat e sjella nga jashtë, pjesa më e madhe e të cilëve ësht shgarkuar në Durrës.

Në vjeshtën e vjetit 1941 janë bërë gjithashtu më të gjalla tre-

./...

BKSH

gëtimet në tokat e liruara, të bazuara mbi shkëmbimin e prodhimeve bujqësore e të bagëtive, caktuar për krahinat e Shqipërisë së Vjetër dhe për eksportimin, dhe të sendevet të punuara të sjella kryesisht nga Italia.

Më vonë, për shkak të vështirësive të shumta e të vazhduarshme në nozullimin e karburantave, të lubrifikantave dhe të pneumatikëve që nevojiten për automjetet - mbi të cilat bazohen krejtësisht trafiket në Shqipërì - tregëtia ka pësuar një ndalim të fortë që vazhdon ènde, dhe që i detyrohet gjithashtu gjendjes së veçantë politike të disa krahinave.

BALLANCIMI TREGËTAR

Shqipëria, si një vënd që importon më shumë prej së jashtëmi,ka pasur edhe në këtë kohë, si dhe në të kaluarën, një pasiv të rëndësishëm në ballancimin e vet tregëtar (lidhja C.). Transferimet për llogarì të Qeverisë Italiane, ndodhja e punëtorëve dhe e Trupave Italiane, nevojat e luftës si dhe ato të inisjativave industriale në realizim e sipër,kanë shkaktuar një shtim të jashtëzakonëshëm në kërkesën e mallërave,veçanërisht mallëra të konsumit, landë ndërtimesh e makinarina, duke i dhënë tregëtisë një hov të jashtëzakonëshëm. Nga kjo gjë ësht shkaktuar një shtim i importimeve, ndërsa eksportimet janë pakësuar nga konsumi i shumtë lokal.

Në periudhën Prill 1939 - Mars 1943 ballanca tregëtare e Shqipërisë ësht mbyllur me një tepricë pasive prej 570,5 milion franga shqipëtare.

Me qëllim të një shqyrtimi më të mirë mbi shvillimin e ballancës tregëtare duhet të ndahet periudha e sipërtreguar në katër periudha të tjera të cilat me rrethanat edhe ngjarjet e tyre, kanë bërë që ballanca tregëtare t'a ndjejë ndryshe influencën e tyre. Këto periudha janë:

1) <u>PREJ MUAJIT PRILL 1939 DERI NË FILLIMIN E LUFTËS ME GREQINË (TETOR 1940).</u>

Importimet - megjithse, në krahasim me vjetet e kaluar, kanë qënë shtuar - janë më të pakta nga ato të vjeteve pasardhës me që në këtë periudhë nuk vërtetohet ènde ajo rrymë e fortë e tregëtimeve që do të bëhet në vjetët 1941/42/43.-

Në këtë periudhë Shqipëria ka importuar mallëra për 8,8 milion franga <u>në muaj</u> dhe ka eksportuar për 1,1 milion franga duke mbyllur ballancën e vet <u>në çdo muaj</u> me një humbje prej 7,7 milion franga shqipëtare.

2) <u>PREJ FILLIMIT (TETOR 1940) DERI NË FUND (PRILL 1941) TË LUFTËS ME GREQINË</u>. Gjatë kësaj periudhe eksportimet me një mesatare prej 400.000 franga në muaj, kanë mbritur pikën më të ulët të mesatares në eksportimet e katërvjetorit 1939/43.-

./.

BKSH

Për rrjedhim të luftës edhe importimet nuk kanë mundur të shvillohen në masë të një-trajtëshme. Në të katër muajt e parë të vjetit 1941 trafiku për nevojat civile ka shënuar pakësimin më të madh të katërvjetorit duke mbritur vetëm në 47 milion franga.

Gjatë luftës me Greqinë kemi pasur gjithësejt një mesatare të përmuajshme prej 10,5 milion franga mall t'importuar.

Për këtë periudhë ballancimi mbyllet kështu me një humbje të përmuajshme prej 10,1 milion franga.

3) PREJ MAJIT 1941 (PERIUDHA ME NJË HERË MBAS FUNDIT TË LUFTËS ME GREQINË) DERI NË JANAR 1942.

Qoftë nga rifillimi i trafikut për nevojat civile, ose nga shumica e porosinave, të cilat nuk ka qënë e mundur të bëheshin në muajt e mëparëshëm, në katërmuajshin e parë të kësaj periudhe të tretë importimet u shtuan ndërsa u pakësuan në muajt vazhduës, për shkak të vështirësive të mbëdha të blerjes në tregjet e origjinës.

Në këtë periudhë importimet, me një mesatare të përmuajshme prej 22,2 milion franga mbrijnë kulmin e katërvjetorit, ndërsa eksportimet, megjithëse mbrijnë deri në 2,8 milion franga në muaj, nuk mbushin veçse 12,6% të humbjes që, me një mesatare prej 19,4 milion franga mbrin pikën më të lartë të tepricës pasive të ballancimit tregëtar të Shqipërisë në katërvjetorin Prill 1939 - Mars 1943.-

Pra, duke pasur gjithashtu parasysh shtimin e çmimeve në vëndin e origjinës - shtim që është vështirë të përcaktohet - mund të thuhet se në këtë periudhë importimet janë shtuar përveç vleftës, edhe në madhësì.-

4) FRUER 1942 - MARS 1943. Eksportimet (mesatarja mujore 2,8 milion franga) që për të gjithë vjetin 1942 mbajnë po atë rythmë të periudhës së mëparëshme (Maj 1941 - Fruer 1942), në trimuajshin e parë të vjetit 1943 shënojnë një smadhim të vogël vlefte për shkak të shtimit që u bëhet çmimeve të mallërave, ndërsa vëllimi mbahet gati i qëndrueshëm.

Importimet pësojnë, përkundrazi, një pakësim duke kaluar në një mesatare të përmuajshme prej 16,4 milion franga (15,8 në periudhën Fruer-Dhjetor 1942 dhe në 18,6 për tremuajshin e parë 1943).-

Në këtë periudhë të fundit, ballancimi tregëtar mbyllet pra, me një tepricë pasive të përmuajshme prej 13,57 milion franga.-

Duke marë parasysh shtimin e çmimeve në vëndin e origjinës dhe pakësimin e krejt vleftës së importimeve, në krahasim me periudhën e mëparëshme, duhet të përfundojmë, sikurse ngjan në të vërtetën, se sasia e importimeve në krahasim me periudhën e mëparëshme, ëdht pakësuar më tepër për shkak të vështirësive të nozullimit në tregjet e huaj.

Duke pasur parasysh kushtet e sipër-treguar për një shvillim më të

./.

BKSH

mirë t'industrisë dhe të bujqësisë shqipëtare, si edhe faktin që humbjet e mbëdha u detyrohen pa tjatër ngjarjeve të jashtëzakonëshme të këtyre katër vjeteve, Shqipëria ësht në shkallë që të mundet - me normalizimin e gjendjes - të pakësojë humbjet e ballancimit të saj tregëtar, në qoftë se nuk do të mungojnë kushtet e përmëndur.-

Ç M I M E T

(Lidhja D.)

Çmimet në Shqipëri kanë qënë ngritur vashdimisht, dhe kjo ngritje - q'u fillua në Prill të 1939-ës - ka qënë në fillim e ngadalëshme, por pastaj shkoi duke u shpejtuar gjatë fushatës së Greqisë deri sa e çoi index-in e përgjithëshëm prej 225 në 335.- Kanë vazhduar pastaj disa muaj qindrueshmënie, por në vjeshtën e vjetit 1941, ngritja rifilloi më me shpejtësì se në çdo tjetër periudhë.

Shtimi, i pakësuar lehtësisht pas mbarimit të dimërit, rifilloi smadhimin e tij - me ndonjë përkulje të lehtë, sikurse në të kaluarën, në periudhën e të vjelave - duke shkaktuar kuotacione të mbëdha edhe për mallërat kryesore, si të lashtat: grurë dhe misër.

Çmimet në sasira të vogëla, duke u nisur nga baza 100 në muajin Prill 1939 kanë mbritur, në mbarim të Marsit 1943, në 1033,4.-

Një lëvizje e tillë e çmimeve shpjegohet nga një radhë faktorësh të ndryshëm dhe kryesisht:

- prej pakësimit të mallërave në tregjet e huaja të prodhimit, gjë që ka shtyrë tregëtarët shqipëtarë të paguajnë mbiçmime për të siguruar nozullimet;

- prej shtimit të shpenzimeve të mbartjes detare, të shpenzimeve të sigurimit dhe t'atyreve të radhës së dytë;

- prej gjendjes së luftës që, në lidhje gjithashtu me eksperiencën e mjerueshme monetare që ka pasur në kohëra të tjera Shqipëria,i ka shtytur tregëtarët dhe konsumatorët:të shumëfishojnë blerjet e tyre dhe të grumbullo në më të shumta nga nevojat normale të tregëtisë dhe nga mundësitë e kërkesave dhe të konsumeve;

- prej mungesës së kontrollimeve të vërteta dhe përfundimsjellëse mbi konsumet dhe mbi çmimet e shumë prodhimeve. Kjo gjë mund t'u jetë përgjegjur kritereve të një "politike të çmimeve të larta" me qëllim që të caktojë një kufizim të konsumeve, jo me anë ndalimesh të detyruara, por duke lënë që çmimet të barazohen me kërkesën, ose konsumet të frenohen me anën e

./.

një çmimi më të lartë.

Ësht e ditur se, duke marë parasysh shumicën e madhe të mallërave t'importimit në tregëtitë dhe në konsumet e Shqipërisë, këto mallëra përbëjnë karakteristikën e tregut; përfaqësojnë d.m.th. faktorin kryesor (padashur të mohojnë me këtë influencën e faktorëve të tjerë të mbrëndëshëm, si ata të prodhimeve, të mbartjeve, etj.) që ka shkaktuar ngritjen e çmimeve edhe për mallërat e prodhimit të vëndit.

Nga ana tjetër, sikurse duket nga diagrama e posaçme (lidhje E.), lëvizja e çmimeve ka qënë e pamvarur nga ajo e dërgesave të fondeve dhe nga qarkullimi. Mund të themi, përkundrazi, në lidhje me faktorët e sipërtreguar dhe me karakterin e ekonomisë në Shqipëri, se dërgesat e fondeve dhe shtimi i qarkullimit kanë përbërë një refleks të lëvizjes së çmimeve dhe jo anasjelltas.-

QARKULLIMI

(Lidhjet E.F.)

Kërkesat e shtuara të tregëtisë dhe të prodhimit kanë sjellë me vehte nevojën e një qarkullimi më të math, ndërsa transferimet e fondeve nga ana e Qeverisë Italiane e kanë përcaktuar këtë nevojë në mënyrë të domosdoshme.

Përhapja e prodhimit dhe e trafikeve ka qënë smadhuar dhe përkrahur nga disponibilitetet liquide të derdhura prej Italisë:

a) për pagimin e një pjese të madhe të punëve botore;

b) për përbërjen e kapitaleve të inicjativave të reja tregëtare dhe industriale;

c) për nxjerrjen e mallërave të vendosura në tregjet italiane.

Të gjitha këto dërgesa fondesh bashkë me të tjerat, për të cilat do të flasim më poshtë (kapitulli i dërgesave), e kanë shtuar qarkullimin monetar që ka pasur një lëvizje progresive si vijon:

- Nga franga 12,5 milion deri më 31 Dhjetor 1938 (duke përmbledhur monedhat divizionale) ka kaluar në 29,8 milion franga (duke përmbledhur gjithënjë monedhat divizionale) në fund të Dhjetorit 1939.-

- Deri më 31 Dhjetor 1940 qarkullimi ishte prej frangash 80.178.000

Ky hov i ndijshëm duhet t'i detyrohet shumicës së fondeve që janë

./.

dërguar në këtë periudhë prej Italie kryesisht për pjesën e madhe të punimeve të ndërmara për nevoja të ndryshme.-

- Më 31 Dhjetor 1941 qarkullimi mbrinte në 108.761.000.- Përveç shkaqeve të përmendura, kjo shtesë i detyrohet edhe aneksimit të Tokave të Liruara.-

- Më 31 Dhjetor 1942 qarkullimi kaloi në 141.897.000.- franga për të mbritur, më në fund, më 31 Maj 1943 në 155.295.000.- franga.

Sikurse thamë, shtimi i qarkullimit i detyrohet lëvizjes së pagesave midis Italisë dhe Shqipërisë. Mbasi në të vërtetën, fondet e dërguara nga Italia nuk kanë qënë mbledhur të gjitha-me anë t'importimeve, me blerje sendesh të paluejtëshme n'Itali nga ana e nënshtetasve shqipëtarë dhe me dërgesat e ushtarëve dhe të punëtorëve - diferenca e derdhur në tregun shqipëtar i ka dhënë hov qarkullimit.-

Megjithkëtë dinamika naltësuese e qarkullimit nuk ka sjellë me vehte farën e inflasionit monetar e huadhënës, me që nuk ësht tjetër veçse një refleks i sgjanimit progresiv të prodhimit dhe t'industrisë më tepër se i trafikeve dhe i tokës (Tokat e Liruara kanë kthyer në gjirin e Shqipërisë 805.265 banorë me të gjitha industritë dhe trafiket e tyre).

Në qoftë se vrejmë vetëm këtë faktor të fundit (sgjerimi i tokës) do të shohim se si qarkullimi, në lidhje me popullatën e shtuar,ësht shtuar vetëm shtatë herë në krahasim me vjetin 1938.-

Me këtë rast vlen të përmendim shkurtimisht politikën huadhënëse të Bankës, që ka pasur për qëllim të përmbajë qarkullimin dhe ngritjen e çmimeve.-

Për këtë punë duhet të kemi parasysh se prej vjetit 1939 e këtej,me gjithë të dalurat për Itali me tituj të ndryshëm, ka qënë shtuar teprica aktive në lira italiane, më shumë për shkak të vështirësive n'importimin e mallërave. Shtimi i kësaj teprice nuk mund të mos influenconte qarkullimin. Por ky, për shkak të politikës huadhënëse të Bankës, nuk ka pësuar të gjithë atë shtim që përndryshe do të pësonte nga lëvizja e tepricës.-

Në qoftë se në muajt e parë mbas Prillit 1939 punimet e reja kanë qënë mbajtur pjesërisht me kredinë Bankare, edhe atëherë gjithashtu shtimi i qarkullimit ka qënë përmbajtur në një vijë shumë më të ulët nga shtimi i disponibiliteteve në lira italiane t'ardhura nga Italia.

Kjo gjë ka qënë e mundur vetëm me anë të një politike përmbajtjeje të kredive që ka qënë ushtruar edhe në vjetët mbasardhës.-

Po të mos ishte bërë kjo përmbajtje, veprimet e kredisë do t'a kishin shtuar pa dyshim qarkullimin në përpjestim me derdhjen e disponibiliteteve në lira italiane.-

Banka përkundrazi ësht munduar që të mos ndihmojë shtimin e qarku-

./.

BKSH

llimit edhe sikur ky shtim të dukej i justifikueshëm prej ngritjes së çmimeve.-

Përmbajtja e kredive, si do qoftë, për aq sa mund të shërbente për të frenuar shtimin e qarkullimit, ka bërë që tendencat ngritëse të çmimeve të mos mbaheshin, qoftë drejt për drejt ose tërthorazi, nga politika monetare e Bankës së emisionit.

Me fjalë të tjera, Banka nuk ka dashur të përkrahë kërkesën e Enteve dhe të privatëve që, nën shtypjen e ngritjes së çmimeve, kanë kërkuar me këmbëngulje një kredi më të madhe.

Me anë të kësaj politike huadhënëse - që ka pasur gjithashtu qëllime me efekte kundër inflacionit - lëvizja e çmimeve nuk ka qënë influencuar nga mjetet e pagesës dhe qarkullimi, për sa ka qënë e mundur, ka qënë përmbajtur në kufì t'arësyeshëm në krahasim me dërgesat e fondeve prej Italie.

Në këtë mënyrë ndërsa këto të fundit, më 31 Korrik 1943, mbrinin shumën prej 1.669.404.000.- franga shqipëtare, qarkullimi po në këtë datë ishte prej 182.915.000.- franga shqipëtare.

DËRGESA FONDESH PREJ ITALIE

Dërgesat e fondeve kanë përbërë shkakun e dukëshëm dhe të menjëherëshëm të shtimit të qarkullimit.

Por ato nuk kanë pasur influencën inflacionistike me që kanë përcaktuar një shtim të vërtetë dhe të pamohueshëm të pasurisë shqipëtare, qoftë me anë të punimeve botore që kanë qënë krijuar për dobinë e përherëshme të Vëndit, qoftë sepse pasuritë kanë qënë ndëruar në pjesën më të madhe, në sende reale duke blerë mallëra t'importuara në Shqipërì (le të marim parasysh për këtë gjë shtimin e çquar të disponibiliteteve procapita të artikujve të ndryshëm), qoftë për mes krijimit të pasurive të paluejtëshme private në Shqipërì dhe jashtë.-

Ato kanë qënë, veç kësaj shkaku kryesor i fuqizimit të sektorit bujqësor dhe i sektorëve të tregëtisë dhe industrisë që janë pasuruar me inisjativa e makinarina të reja si edhe me installime që padyshim do t'i sjellin mirëqënie të gjithë Vëndit.

Dërgesat kanë qënë gjithësejt, prej muajit Prill 1939 deri më 31 Gusht 1943, 1.692.204.000.- franga shqipëtare.

Kësaj shume i shtohen transferimet e bëra me anën e bankave të tjera që veprojnë në Shqipërì, si edhe dërgesa të kryera jashtë rrethit Bankar shqipëtar (çeqe ose bankënota të pathyera në bankë, pagesa të rregullluara me shkëmbime private ose mbi llogarina pranë bankash n'Itali etj.).-

Sikurse thamë më sipër shkaqet themelore të këtyre transferimeve i

./.

BKSH

detyrohet kryesisht programit të gjërë të punëve botore, i pregatitur në fillim prej administratave italiane për shpenzimet e mbëdha të bëra për shkaqe të ndryshme.-

Për arësyena që dihen, kemi pasur pastaj, në përgjithësì, një prirje për pakësim: nga mesatareja e përmuajshme prej 58 milion frangash gjatë fushatës greke, kemi mbritur për gjithë vjetin 1942, në një mesatare të për muajshme prej franga shqipëtare 24,9 milion. Në vjetin vazhdues (Janar-Gusht) mesatarja ka zbritur në 22,8 milion franga.

Në të njëjtën kohë, dërgesat për llogarì të privatëve kanë mbetur afro të pandryshuara, me një pakësim të vogël në këto kohët e fundit, kështu që transferimet, në përgjithësì, kanë shkuar duke zbritur (lidhja H.)

Në këtë paraqitje synthetike e fragmentare të punëve më me rëndësì t'industrisë dhe t'ekonomisë shqipëtare, gjatë katërvjetorit Prill 1939 - Mars 1943, nuk e kemi parë t'arësyeshme të marim si bazë ndonjë vjet të mëparëshëm për të caktuar një paralele me periudhën në shqyrtim. Kjo periudhë me ngjarjet dhe rrethanat e veta të veçanta duhet të quhet e jashtëzakonëshme dhe, si e tillë, nuk ka mundësì që të krahasohet dhe të paralelizohet në mënyrë që të identifikojë e të vërë në dukje një vazhdueshmënì punësh e ngjarjesh.

Nga vështirësia për të pasur shënime për secilin muaj veçmas, dhe për lehtësì të vizatimit të grafikeve e të diagrameve, ka qënë e nevojshme, për disa nga çështjet e maruna në shqyrtim, që të shkojshin më tej nga Marsi 1943 dhe në disa raste, pikërisht për të treguar karakterin e jashtëzakonëshëm të ndonjë çështjeje të katërvjetorit, e kemi lidhur këtë me njerin nga vjetët e mëparëshëm.

Veç kësaj, vështirësitë për të pasur shënile zyrtare për ndonjë nga fenomenet ekonomike vërtetuar në katërvjetorin 1939/1943, na kanë shtrënguar të drejtohemi në burime të ndryshme.-

Asgjëmangut, në këtë rast, kemi vepëruar me shumë kujdes në gjetjen e shënimeve të cilat, për këtë arësye, mund të mbahen shumë të besueshme.

BKSH

LIDHJE A.

BKSH

BKSH

PRODHIME KRYESORE TË BUJQËSISË

PERJASHTUE TOKAT E LIRUARA

LLOJË TË BIMËVE	1939	1940 (1)	1941 (1)	1942 (1)
	në mijëra kv.			
DRITHËRA:				
grurë	502	298	412	431
misër	1.234	1.383	1.279	1.156
tërshanë	130	75	104	999
elb	52	32	37	49
oriz	6	4	5	5
drithëra të tjera	76	65	55	72
LEGUMINOZE:				
fasule	39	39	47	59
BIMË PERIMORE:				
patate	35	33	31	60
BIMË INDUSTRIALE				
pambuk	3	3	4	2
duhan	27	25	27	26
BIMË DRUNI				
ullinj	299	207	115	195

Shenim: Gjithë prodhimi i drithnave në tokat e lirueme ka qenë çmue për vjetin 1942 në ma tepër se 2.000.000.- kuintalë.

(1) Shenime jo zyrtare

BKSH

BKSH

PRODHIMET KRYESORE TË BUJQESISË

me perjashtimin e prodhimit të tokave të çliruome

GRUNË



MISER



TERSHANË



ELB



BARISHTE



DUHAN



BKSH

BKSH

PRODHIME KRYESORE TË BUJQËSISË

PERJASHTUE TOKAT E LIRUARA

GRURË



MISËR



TËRSHANË



BASHKË ME TOKAT E LIRUARA

GRURË



MISËR



TERSHANË



BKSH

BKSH

PRODHIMI, IMPORTIMI DHE KONSUMI I GRURIT

VLEFTAT ABSOLUTE DHE NUMRAT TREGUES

VJETËT	Populllsia		Prodhimi		Importimi (2)		Konsumi për secilin banor (2)	
	Vleftat absolute	Numerat tregues	Kvintal	Numerat tregues	Kvintal	Numerat tregues	Kgr.	Numerat tregues
1938	1.057.393	100	379.373	100	131.247	100	48,2	100
1939 (1	1.118.148	105	502.158	132	144.371	109	57,8	119
1940 (1	1.118.148	105	298.099	78	183.745	139	43	89
1941 (1	1.923.413	181	1.200.000	316	161.827	123	70,8	146
1942 (1	1.923.413	181	1.100.000	289	27.428	20	58,6	121

(1) *Shenime jo zyrtare.*
(2) *Me përjashtim të miellit të grurit, importimi të cilit ka qënë 1941-1942 shumë i math (174.590 Kvintalë ne 1941 - 213.423 Kvintale në 1942).*

PRODHIMI, IMPORTIMI DHE KONSUMI I MISERIT

VLEFTAT ABSOLUTE DHË NUMRAT TREGUES

VJETËT	Popullsia		Prodhimi		Importimi		Konsumi për secilin banor (2)	
	Vleftat absolute	Numerat tregues	Kvintal	Numerat tregues	Kvintal	Numerat tregues	Kgr.	Numerat tregues
1938	1.057.393	100	1.425.000	100	182.953	100	152	100
1939 (1)	1.118.148	105	1.233.726	86	201.248	109	128	84
1940 (1)	1.118.148	105	1.383.222	97	128.067	69	135	88
1941 (1)	1.923.413	181	2.200.000	154	26.642	14	116	76
1942 (1)	1.923.413	181	2.000.000	140	3.109	2	104	68

(1) *Shenime jo zyrtare:*

PRODHIM I GRURIT

ME PERJASHTIM TË TOKAVE TE LIRUARA

(1) Shënime jozyrtare

Prefekturat	1939			1940 (1)			1941 (1)			1942 (1)		
	Sipërfaqe Ha	Prodhimi K.v.	Prodhimi për hektar	Sipërfaqe Ha	Prodhimi K.v.	Prodhimi për hektar	Sipërfaqe Ha	Prodhimi K.v.	Prodhimi për hektar	Siperfaqe Ha	Prodhimi K.v.	
Gjinokastër	6.089	52.980	8,7	6.365	44.873	7	4.601	29.115	6,3	3.424	25.000	7,3
Berat	10.932	103.700	9,4	7.996	44.546	5,5	8.942	61.155	6,8	13.431	87.306	6,5
Korçë	13.640	159.146	11,6	15.061	114.657	7,6	13.600	140.000	10,2	15.583	141.685	9
Durres	3.805	55.046	14,4	1.700	11.453	6,7	3.002	28.318	9,4	2.796	27.401	9,8
Elbassan	3.653	36.707	10	2.856	19.672	6,8	4.123	32.853	7,9	4.339	35.000	8
Kukës	504	4.963	9,8	576	7.285	12.6	411	4.326	10,5	452	4.996	11
Peshkopi	1.484	14.407	9,7	1.194	11.016	9,2	4.469	42.013	9,4	4.736	45.000	9,5
Shkodër	3.674	40.115	10,9	2.742	23.449	8,5	6.428	45.000	7	5.983	36.500	6,1
Tiranë	510	5.513	10,8	307	2.281	9,3	326	3.095	9,4	821	5.177	6,3
Vlorë	3.369	29.581	8,7	3.255	18.267	5,6	3.407	26.151	7,6	2.965	23.000	7,7
SHUMA	47.669	502.158	10,7	42.181	298.099	7,1	49.309	412.026	8,3	54.531	431.066	7,9

Shënim: Prodhimi i grurit në Tokat e Liruara ka qënë në vjetin 1941 rreth 1.000.000. Kv. (prej te cilit 900.000 Kv. në Kosovë, dhe mbetja në Dibër, dhe në 1942 rreth 700.000 Kv. prej të cilit 600.000 në Kosovë, dhe mbetja në Dibër).- Në 1942 prodhimi ka qënë më shumë se 10 Kv. për hektar, në Kosovë, dhe afro 13 Kv. hektar në Dibër.

BKSH

PRODHIMI I MISERIT
ME PERJASHTIM TOKAT E LIRUARA

(1) Shenime jozyrtare.

PREFEKTURAT	1939			1940 (1)			1941 (1)			1942 (1)		
	Sipërfaqe Ha	Prodhim Kv.	Prodhimi për hektar	Siperfaqe Ha	Prodhim Kv.	Prodhimi për hektar	Siperfaqe Ha	Prodhim Kv.	Prodhimi për hektar	Siperfaqe Ha	Prodhim Kv.	Prodhimi për hektar
Gjinokaster	11501	129065	11,2	10548	115542	10,9	9922	86710	8,7	8252	81700	9,9
Berat	27252	279806	10,2	29655	315910	10,6	29479	316375	10,7	23800	250000	10,5
Korçe	9649	131759	13,6	11409	137770	12	10010	123000	12,2	9736	131858	13,5
Durres	12289	144939	12,7	12076	161721	13,3	16549	151228	9,1	7414	86749	11,7
Elbassan	12676	143147	11,3	13791	169322	12,2	16498	134921	8,1	15566	165100	10,6
Kukes	2545	36615	14,3	2341	40477	17,2	2695	25023	9,2	2527	34031	13,4
Peshkopi	7495	106900	14,3	7330	110559	15	7879	103311	13,1	9352	130000	13,9
Shkoder	12354	158352	12,9	16206	231411	14,2	25227	250000	9,9	16500	175000	10,6
Tiranë	2973	36274	12,2	3288	41732	12,6	3714	37948	10,2	4293	49799	11,6
Vlorë	4965	66863	13,4	6357	58778	9,2	6773	50467	7,4	7265	51268	7,1
SHUMA	103703	1233726	11,9	113004	1383222	12,2	128476	1278983	9,9	104705	1155325	11

Shenim. Prodhimi i miserit ne Tokat e Liruara ka qënë në 1942 afro 900.000 Kv. (prej te cilave me se 750.000 ne Kosovë dhe teprica ne Diber).

AQSH

BKSH

PRODHIMI I DRITHNAVE TE DORES SE DYTE

ME PERJASHTIM TE TOKAVE TE LIRUARA

në Kv.

1) Shënime jozyrtare.

PREFEKTURAT	TERSHANË 1939	TERSHANË 1940 (1)	TERSHANË 1941 (1)	TERSHANË 1942 (1)	ELB 1939	ELB 1940 (1)	ELB 1941 (1)	ELB 1942 (1)	ORIS 1939	ORIS 1940 (1)	ORIS 1941 (1)	ORIS 1942 (1)	DRITHNA TE TJERA 1939	DRITHNA TE TJERA 1940 (1)	DRITHNA TE TJERA 1941 (1)	DRITHNA TE TJERA 1942 (1)
GJINOKASTËR	7.256	8.422	6.742	4.818	4.357	4.460	4.867	5.386	2.144	1.716	1.930	1.823	7.836	6.163	4.490	5.326
BERAT	41.501	24.688	37.232	21.000	12.247	7.322	5.400	5.000	125	15	70	42	13.585	10.587	7.592	9.089
KORÇE	11.788	11.321	13.609	13.200	13.899	6.351	12.973	11.500	–	–	–	–	26.388	21.153	15.918	30.187
DURRES	18.317	6.830	7.824	16.445	1.262	1.069	1.140	1.768	–	12	6	9	1.976	1.957	1.939	1.946
ELBASAN	26.408	7.746	18.035	10.000	8.067	3.830	1.672	5.000	3.767	2.504	3.135	2.820	16.314	16.285	16.257	16.271
KUKËS	965	1.287	1.400	1.217	2.963	3.043	3.253	3.077	–	–	–	–	3.378	3.207	3.037	3.122
PESHKOPI	1.274	1.083	2.146	8.000	2.485	2.121	970	7.000	–	–	–	–	4.543	3.345	2.148	2.746
SHKODER	943	695	1.213	2.500	2.511	1.573	4.450	7.000	–	–	–	–	817	1.123	1.429	1.276
TIRANË	4.879	2.305	3.076	4.269	625	509	416	326	24	–	12	18	1.309	1.481	1.653	1.567
VLORË	16.429	10.899	13.000	18.000	3.567	2.125	1.400	2.500	40	–	20	30	190	157	124	145
SHUMA	129.760	75.276	104.277	99.449	51.956	32.406	36.541	48.557	6.100	4.247	5.173	4.742	76.336	65.458	54.587	71.675

Shenim: Prodhimi i Tershanës ne Tokat e Liruara ka qënë ne 1942 rreth 130.000 Kv.; ai i elbit rreth 270.000 Kv.

AQSH

BKSH

PRODHIME TË TJERA BUJQËSORE
ME PËRJASHTIM TË TOKAVE TË LIRUARA
— në K.V. —

PREFEKTURAT	FASULE				PATATE				DUHAN				PAMBUK			
	1939	1940(1)	1941(1)	1942(1)	1939	1940(1)	1941(1)	1942(1)	1939	1940(1)	1941(1)	1942(1)	1939	1940(1)	1941(1)	1942(1)
GJIROKASTËR	2.473	2.545	2.617	3.454	9.343	7.288	5.235	6.271	2.862	2.109	2.485	2.297	69	—	—	—
BERAT	1.996	3.740	5.485	7.240	328	498	670	584	6.462	5.144	5.803	5.473	2.617	3.000	3.500	1.500
KORÇË	12.937	17.104	21.272	24.223	6.309	8.417	10.525	37.577	1.289	1.039	348	212	8	—	—	—
DURRËS	1.309	2.637	3.888	5.132	2.473	3.752	5.032	4.492	1.660	1.576	250	300	123	—	—	—
ELBASAN	2.361	2.997	3.633	4.795	776	615	453	534	5.447	5.227	7.200	6.000	66	—	—	—
KUKËS	965	933	902	1.118	2.236	1.717	1.208	1.462	368	244	306	275	—	—	—	—
PESHKOPI	3.976	4.822	5.669	7.483	384	249	114	181	1.437	834	1.135	984	—	—	—	—
SHKODËR	3.179	3.128	3.080	4.065	11.240	9.620	8.000	8.000	4.026	6.807	7.017	9.283	—	—	—	—
TIRANË	1.074	1.064	1.053	1.389	222	220	220	220	1.330	1.035	1.167	550	25	—	—	—
VLONË	433	267	102	134	1.674	807	40	423	1.808	1.123	1.465	100	—	—	—	—
SHUMA	30.703	39.237	47.701	59.033	34.983	33.183	31.497	59.744	26.685	25.138	27.176	25.474	2.908	3.000	3.500	1.500

1) Shënime jo zyrtare.

AQSH

PASUNIA BLEGTORALE

TUE PËRFSHIMË TOKAT E LIRUEME

NUMURI I KRENËVE



SHËNIM_ Përbamja numerike e gjedhvet, dhive dhe e derravet ka prirje të pakësohet nga shtimi i të therunave që i detyrohet çmimit të naltë të mishrave dhe të lëkurëvet, dhe nga vështirësitë e mbartjeve të mbrendëshme që pengojnë transferimet prej krahinave të pasuna në bagëti në ato të varfërat – Çmimi i naltë i leshit dhe i qumështit ka shkaktue nji shtim të dhënvet – Nuk rezulton që përbamja e kuajvet dhe e shpendëve të ketë pësue ndryshime të mbëdha–

PRODHIMI LËKUREVË
Perfshim tokat e Çiruara

Lloji i lekureve	1941	1942
	mijash copë	
LËKURA TË ZAKONËSHME:		
dhëntsh — qingja	500	400
dhëntsh — dele	60	35
dhëntsh — desh	260	185
dhëntsh — dhi	270	385
gjedhësh	15	19
Kuajsh	1	1
Shuma e lëkurve të zakonëshme	1.106	995
LËKURË TË ÇMUSHME:		
Shqarth	2	1.5
dhelpëra	7	12
Kunadhe	0.7	1.7
vjedulla	0.4	0.7
lundërza	0.2	0.2
Lepura	52	45
Shuma e lekurve të çmushme	62,3	61.1

BKSH

LIDHJE B.

BKSH

KUADER I USHTRIMEVE INDUSTRIALE

KLASAT INDUSTRIALE	NUMRI		USHTRIME në PROJEKT
	USHTRIME	PËRKATESË	
Industrina të lidhuna me bujqësinë	4	3.760 (1)	
" nxjerrëse	25	5.339	1
" Ushqimore dhe analoge	39	854	2
" druni dhe analoge	42	790	
" lekuresh të ndryshme	12	190	
" siderurgjike dhe metalurgjike	2	27	1
" mekanike	12	316	
" mineralesh jo metalike	16	615	3
" pelhurnash	6	230	
" Kimike	31	618	1
" prodhim e shpërndamje drite	14	167	
SHUMA	203	12.906	8

Shënim : Fuqija e gjithësejshme afër 30.000 HP.

1) Nuk janë marrë parasysh industrinat e ndërtimeve dhe të mbartjeve për të cilat na mungojnë shenime te sigurta.

2) Perfshihen 648 familje bujqësh.

BKSH

BKSH

INDUSTRIA MINERARE

MINERALE	SASIRA TË VERTETUARA -2-	PRODHIMI 1)
	NË MIJËRA TONELATA	
Vajguri 3)	15.000	155
Lignite {xyloide	?	100
Lignite {picéa	?	31
Bitum	?	15
Kromit 4)	500	36
Kalkopirit 5)	?	12
Pirit Kuprifer 6)	5.000	—
Minerale të hekurit 7)	20.000	—
Argjile nikelifere	50	—
Solfure të përziem	8.000	—
Klorur i sodium-it 8)	—	23

Shenim: Perveç mineraleve të sipërtreguar janë gjetur gjurma te mineraleve të tjerë që vijojnë:

minerale metalike: cinabrë, pirrotinë, nickel, minerale të plumbit, galena argjentifera, ar (në përpjesëtim shumë të ulët 3 gr. për Ton. material aurifer.)

minerale jo metalike: Amiant serpentini, minerale të arsenikut, quarz, gjips, talk, asbest, argjil, bauxit, pirolusite.

1) Shënime jo zyrtare – Tue permbledhe prodhimin e tokave të liruara.
2) Kan mundësi për shtesa të tjera. 3) Vajguri i dëndur që jep një prodhim në benzinë prej 13% me anë distilazioni të thjeshtë, 40% me anë distilazioni dhe pyroscissione, 80% me proçeset e reja të idrogjenasjonit me temperaturë shumë të lartë dhe presjon. 4) Përmban 45 deri me 50% oksid të kromit
5) Perpjesetimi me bakrim ndryshohet nga 10 deri më 30% afro.
6) Perpjesetimi me bakrim afro 20%.
7) Ematit (që perfaqëson përqindjen ma të madhe të sasisë se vertetuar).
8) Nxjerrje detare.

AQSH


PRODHIMET KRYESORE MINERALE
Krahasim Prodhimi 1935-1942
T. 12.500
T. 155.000
1935 1942
VAJ-GURI
T. 11.000
T. 15.000
1935 1942
BITUM
T. 3.000
T. 40.000
1935 1942
KROM
T. 2.500
T. 131.000
1935 1942
LIGNIT

BKSH

LIDHJE C.

BKSH

BKSH

BALLANCA E TREGËTISË

GJITHËSEJT - PERIUDHA: Prill 1939 - Mars 1943



PËRVJETSHËM - PERIUDHA: 1939 deri 1942

vlefta të perpjesëshme



BKSH

TREGËTIA ME VENDET E HUAJA

IMPORTIME



EKSPORTIME



HUMBJE



PËRQINDJE
EKSPORTIME MBI IMPORTIME



BKSH

BKSH

TREGËTI ME VENDET E HUAJA

NË MILIONA FRANGA SH.

VLEFTAT ABSOLUTE

VJETA	ITALI			VENDE TJERË			SHUMA		
	IMPORTIM	EKSPORT.	DEFICIT	IMPORTIM	EKSPORT.	DEFICIT	IMPORTIM	EKSPORT	DEFICIT
1938	8.3	6.1	2.2	14.4	3	11.4	22.7	9.1	13.6
1939 (1)	95	11.9	83.1	10.6	1.3	9.3	105.6	13.2	92.4
1940 (1)	105.4	8	97.4	20.4	1.2	19.2	125.8	9.2	116.6
1941 (1)	198.5	11.6	186.9	25.1	1.8	23.3	233.6	13.4	210.2
1942 (1)	168	30	138	28.9	3.1	25.8	196.9	33.1	163.8
Shuma katër vjetorit 1939-1942	566.9	61.5	505.4	85.0	7.4	77.6	651.9	68.9	583.0

VLEFTË PËRQINDJEJE

VJETA	ITALI			VENDE TJERË			SHUMA		
	IMPORTIM	EKSPORT.	DEFICIT	IMPORTIM	EKSPORT.	DEFICIT	IMPORTIM	EKSPORT.	DEFICIT
1938	36.5	67	16.1	63.5	33	83.9	100	100	100
1939	89.9	90.1	89.9	10.1	9.9	10.1	100	100	100
1940	83.7	86.9	83.5	16.3	13.1	16.5	100	100	100
1941	88.7	86.5	88.9	11.3	13.5	11.1	100	100	100
1942	85.3	90.6	84.2	14.7	9.4	15.8	100	100	100
Shuma katërvjeçore 1939-1942	86.9	89.2	86.6	13.1	10.8	13.4	100	100	100

1) Shënime jo zyrtare

BKSH

BKSH

TREGËTIA ME VENDET E HUAJA

Vleftat absolute

Mesataret muajore



BKSH

BKSH

SASIJA DHE VLEFTA E DISAVE PREJ IMPORTIMEVE KRYESORE

VJETET	SASIJA K. v.		VLEFTA në mijëra Fr. shq.		SASIJA K. v.		VLEFTA në mijëra Fr. shq.	
	Shifra absolute	Treguesi bazë 1937=100	Shifra absolute	Treguesi bazë 1937=100	Shifra absolute	Treguesi bazë 1937=100	Shifra absolute	Treguesi bazë 1937=100
	GRURË				SHEQER			
1937	43.711	100	711	100	42.697	100	496	100
1938	131.247	300	1.622	228	47.010	110	606	122
1941	161.827	370	4.389	617	79.088	185	3.667	739
1942	27.428	59	1.300	182	48.707	114	2.884	581
	MIELLI I GRURIT I ËNDËS E TJERA				KAFE			
1937	3.005	100	61	100	5.930	100	392	100
1938	2.988	99	54	88	6.079	102	331	84
1941	174.590	5.809	5.562	9.118	3.572	60	361	92
1942	213.423	7.102	7.479	12.260	218	3	55	14
	MISËR				VERË E VERMUTH			
1937	152.465	100	1.348	100	378	100	35	100
1938	182.953	119	1.630	120	416	110	46	131
1941	26.642	17	390	28	266.198	70.422	21.232	60.662
1942	3.109	2	183	13	140.920	37.280	9.342	26.691
	ORIZ				BIRRË			
1937	26.825	100	400	100	2.140	100	65	100
1938	27.047	101	426	106	2.491	116	87	133
1941	48.752	181	1.588	397	16.364	764	1.728	2.658
1942	49.249	183	1.808	452	21.204	990	1.742	2.680

BKSH

SASIJA DHE VLEFTA E DISAVE PREJ IMPORTIMEVE KRYESORE

VJETËT	SASIJA në kuintal		VLEFTA në mijëra fr.sh.		SASIJA në kuintal		VLEFTA në mijëra fr.sh.	
	Shifra absolutë	Tregues bazë 1937=100	Shifra absolutë	Tregues bazë 1937=100	Shifra absolutë	Tregues bazë 1937=100	Shifra absolutë	Tregues bazë 1937=100
	PËLHURA PAMBUKU				AUTOMJETE (2)			
1937	12.890	100	2.843	100	116	100	281	100
1938	16.659	129,2	3.383	118	206	177	510	181
1941	8.795	68	7.401	260	1.204	1.037	6.767	2.408
1942	30.998	240	30.896	1.086	503	433	2.072	737
	PËLHURA LESHI				DRU ÇFARDO TË PREME			
1937	1.047	100	756	100	111.240	100	432	100
1938	1.225	117	869	114	142.920	128	620	143
1941	2.916	278	6.218	822	662.709	593	12.861	2.977
1942	7.749	740	7.724	1.021	218.779	196	7.354	1.702
	MBATHJE KËMBËSH (1)				GËLQERE, ÇIMENTO, GJIPS			
1937	999	100	28	100	27.760	100	54	100
1938	232	-	17	60	19.632	70	37	68
1941	42.937	-	3.621	12.932	87.557	304	602	1.114
1942	3.438	-	233	832	531.184	1.912	4.903	9.079
	MAQINA DHE APARATE				BARNA MJEKËSORE			
1937	3.652	100	495	100	1.442	100	482	100
1938	4.219	115	547	110	1.614	111	417	86
1941	31.472	861	7.134	1.441	4.609	319	2.491	516
1942	29.242	800	9.078	1.833	7.477	518	3.354	695

(1) *Palë*
(2) *Numur*

BKSH

BKSH

SASIJA DHE VLEFTA E DISAVE PREJ EKSPORTIMEVE KRYESORE

VJETËT	SASIJA në kuintal		VLEFTA në mijëra fr. sh.		SASIJA në kuintal		VLEFTA në mijëra fr. sh.	
	Shifra absolutë	Tregues bazë 1937=100	Shifra absolutë	Tregues bazë 1937=100	Shifra absolutë	Tregues bazë 1937=100	Shifra absolutë	Tregues bazë 1937=100
	KAFSHË TË GJALLA (1)				PESHQ			
1937	55.252	100	892	100	3064	100	152	100
1938	42.452	76	810	90	2529	82	143	94
1941	996	2	272	30	739	24	386	253
1942	415	1	143	16	287	9	49	32
	DJATHËRA				BARISHTA TË THATA			
1937	7.961	100	950	100	16057	100	329	100
1938	7.230	90	828	87	25639	159	589	179
1941	13	0,2	4	0,2	111	1	77	23
1942	41	0,5	3	0,2	5168	32	628	190
	LESH NATURAL				LËKURË TË PAPUNUARA			
1937	12.979	100	1.833	100	9469	100	1.484	100
1938	1.858	14	322	17	8325	87	1.316	88
1941	1.988	15	625	34	8385	88	5.042	339
1942	3.117	24	1.788	97	13339	140	11.668	786
	BITUME TË NGURTË				VAJRA MINERALE TË PAPUNUAR			
1937	101.412	100	510	100	592710	100	1.185	100
1938	120.062	118	542	106	1052453	177	2.105	177
1941	45.345	44	496	97	1062749	179	2.167	182
1942	111.283	109	2.271	445	1579944	266	6.680	563

(1) Numur

BKSH

TREGETI ME VËNDET E HUAJA

NE MILIONA Fr. SHQ.

VJETE	importime		eksportime		deficit		Përqindje eksportime mbi importime
	shifra absolute	mesatare mujore	shifra absolute	mesatare mujore	shifra absolute	mesatare mujore	
1938	22,7	1,8	9,1	0,7	13,6	1,1	22
1939 (1)	105,6	8,8	13,2	1,1	92,4	7,7	12
1940 (1)	125,8	10,4	9,2	0,7	116,6	9,7	7
1941 (1)	223,6	18,6	13,4	1,1	210,2	17,5	6
1942 (1)	196,9	16,1	33,1	2,8	163,8	13,3	17
Trimuj. 1°-1943	55,8	18,6	8,7	2,9	47,1	15,7	15
shuma prill 1939-III-1943	658,8	13,7	88,3	1,8	570,5	11,9	13

NUMRAT TREGUES

BAZË 1938=100

VJETE	importime	eksportime	deficit
1938	100	100	100
1939	466,1	145	679,4
1940	554,1	101	857,3
1941	985	147,2	1.545,6
1942	863,4	363,7	1.204,4
Trimujshi 1°-1943	983,2	382,4	1.385,2
Treguese mesatare Katër-vjetore prill 1939-mars 1943	725,5	241,7	1.048,5

(1) shënime jo zyrtare

BKSH

NUMURA TREGUËS
TË
TREGETISË SË JASHTME

Baza: 1939=100



BKSH

BKSH

TREGETIA E JASHTËME PER SEICILIN VËND

ne mijëra frangash

	1938		1939 (1)		1940 (1)		1941 (1)		1942	
	import.	eksport.	import.	eksport.	import.	eksport.	import.	eksport	import.	eksport.
Itali	8.327	6.133	95.040	11.880	105.400	8.000	198.500	11.600	167.966	30.007
Gjermani	1.255	—	3.174	—	2.925	—	3.582	—	5.748	86
Greqi	735	1.424	795	312	325	37	1.292	1.497	1.449	1.279
Bullgari	1.000	—	546	—	477	—	218	—	413	126
Jugosllavi	2.520	66	4.079	145	12.325	—	14.194	—	9.930	1.211
Rumania	2.285	—	1.165	—	983	—	5.026	—	9.703	—
Vende të tjera	6.546	1.506	841	843	3.365	1.163	788	303	1.707	415
	22.668	9.129	105.600	13.200	125.800	9.200	223.600	13.400	196.916	33.124

(1) Shënime jo zyrtare.

BISH

BKSH

IMPORTIME NGA SEICILI VEND

Përqindje







	1938	1939	1940	1941	1942
Italia	36.7	90.0	83.7	88.7	85.3
Gjermania	5.5	3.0	2.3	1.6	2.9
Greqia	3.1	0.7	0.4	0.7	0.8
Bullgaria	4.3	0.6	0.5	0.2	0.2
Jugosllavia	11.1	3.8	9.7	6.3	5.0
Rumania	10.0	1.1	0.8	2.2	4.9
Vende tjerë	29.3	0.8	2.6	0.3	0.9





BKSH

LIDHJE D.

BKSH

BKSH

NUMERAT TREGUES TË ÇMIMEVE TË VËNDIT ME SHUMICË DHE ME PAKICE

(BAZA : mars 1939 = 100)

DATA		treguës çmime me shumicë			tregues çmime me pakicë
		gjana ushqimore	gjana tjera	Tregues i përgjith.	
mars	1939	100	100	100	100
dhjetor	1939	143,8	152,5	147,4	143,5
tetor	1940	222,6	228,2	224,8	218,5
dhjetor	1940	278,5	263,7	272,5	262,2
prill	1941	371,9	329,8	335,3	341,6
dhjetor	1941	591,3	510	559,3	496,8
dhjetor	1942	1.288,8	789,6	1.096,9	945,2
janar	1943	1.393,3	798	1.166,8	1.006,5
shkurt	1943	1.413,3	822,1	1.192,7	1.034,4
mars	1943	1.334,1	834,1	1.151,4	1.033,4
prill	1943	1.394,1	831,3	1.117,1	1.030,8
maj	1943	1.338,9	794,3	1.128,1	1.011,9
qershor	1943	1.350,3	890,5	1.152,5	1.070,6

Shenim: Në hartimin e numeravet tregues të çminevet të vendit me shumicë janë marrë parasysh 34 mallna, nga të cilat 19 në lidhje me sendet ushqimore, dhe 15 me sende të tjera. Në këtë zgjedhje përfshihen mallna të prodhimit të vëndit dhe ato qe importohen ma shumë, gjithashtu mallnat qe ushqejnë një korent eksportimi të fortë. Shënimet që kemi përdorur pasqyrojnë, për mallërat që prodhohen në vënd, çmimet e përdorur në tregjet kryesorë të prodhimit; per mallrat që ushqejnë tregtin e importimit nga jashtë çmimet që perdoren ndër dy limanet kryesorë të Durrsit dhe të Vlonës.

BKSH

NUMRA TREGUES ÇMIME

BAZË: mars 1939=100



NUMRAT TREGUES MBI ÇMIMET E JETESËS NE· DISA NGA QYTETET KRYESORË

(B A Z A : mars 1939 = 100)

D A T A		TIRANË	DURRËS	KORÇË	SHKODËR	VLORË	GJIROKASTËR
mars	1939	100	100	100	100	100	100
dhjetor	1939	132,1	126,4	139,5	141,9	153,2	125,2
dhjetor	1940	253,6	254	-	275,7	265,6	-
dhjetor	1941	497,7	391,4	607,1	493,5	432,1	559,2
dhjetor	1942	829,8	759	1.190,2	782,3	993,1	1.116,6
Janar	1943	852,9	888	1.262,4	813,3	1.142,3	1.080,3
Shkurt	1943	905,1	897,7	1.301,8	866	1.231,4	1.058,8
Mars	1943	953,8	902,6	1.246,2	917,3	1.190,1	990,4
Prill	1943	983,3	895,4	1.245,1	929,2	1.131,5	1.000,5
Maj	1943	1.009,5	868,9	1.173,4	930,9	1.111,3	977,5
Qershor	1943	1.080,9	902,3	1.122	1.178,9	1.101,2	1.038,3

Shënim: Në hartimin e numrit treguës të çmimit të jetesës, ne qytetet kryesorë, janë marrë parasysh 24 mallna të zgjedhuna nga ato ma të rënëdësishmet që konsumohen ma shumë dhe që prodhohen në vend.

BKSH

ÇMIMET MESATARE ME SHUMICË TË SENDEVE USHQIMORE ME KRYESORE

ÇMIMET NË FRANGA PËR KVINTAL

PRODHIMET	XII-1939	XII-1940	XII-1941	XII-1942	IX-1943
Grurë i fortë	24,5	41,7	145	367,5	280
Grurë i butë	23,3	41,4	130	350	270
Misër	20,4	36	121	270	190
Tërshërë	20,1	39,8	90,7	172	120
Elb	19,6	37,4	84,2	202	157,5
Makarona	59,4	63,5	74,8	85,8	-
Oris i dorë së parë	37,5	47	50,9	99,8	-
Mishëra të theruna: mish kau	110	193,7	287,5	485	850
Mishëra të theruna: mish dashi	116	187,5	286,6	472,5	883,3
Fasule	49,3	107,8	118	171	205
Sheqer pluhun	85	127	151,2	159,8	-
Qumësht lope 1)	40,5	57,5	101,2	192,5	258,3
Djathe i bardhë	130	240	425	812,5	1200
Voj udhini	137	255	472,5	776,6	1550

1) çmime për hektolitër

BKSH

BKSH

ÇMIMET MESATARE ME SHUMICË TË SENDEVE ME KRYESORE JO USHQIMORE

Çmimet në franga për kvintal

PRODHIMET	XII-1939	XII-1940	XII-1941	XII-1942	IX-1943
Lëkurë dhish të pa punuara 1)	310	400	1110	1270	1100
Lëkurë deshësh të pa punuara	286	300	650	650	633
Lesh i pa larë	230	307	585	1060	1500
Naftë	21,5	33,3	34	70	100
Qymyr druni	11,4	19,2	28,1	43,5	53,7
Tulla të mbushme për ndërtime 2)	43	84,3	132,5	220	233,3
Dru (drasa ahu) 3)	107,9	159	291,2	687,5	750
Dru (trenj ahu) 3)	95,8	142	236,2	580	510
Çimento	6,8	10,5	26	46,5	-
Alkool i thjeshtë 4)	352	384	900	-	3150
Duhan i Kualitetit të parë	230	487,5	508,3	833,3	1150

1) çmim për njëqind lëkurë.
2) " " njëmijë tulla.
3) " " metër kub.
4) " " ektanidër.

BKSH

BKSH

NUMURA TREGUES

TË ÇMIMEVE TË DISA SENDEVE USHQIMORE ME SHUMICË

Bazë: Mars 1939=100



BKSH

BKSH


VAJ ULLINI
OLIO DI OLIVA
DJATHË
FORMAGGIO
MISH LOPE
CARNE BOVINA
1943
1939
1943
1939
1943
1939
1943
13
202
Mars 1939 lek 5
Nanduer 1943 " 117
Mars 1939 lek 5
Nanduer 1943 " 158
Mars 1939 lek 4
Nanduer 1943 " 60
Prof. Kodheli

BKSH

DISPONIBILITETI MESATAR PER SECILIN BANOR I DISA SENDEVE USHQIMORE

SENDET	mesatare 1937-1938	mesatare 1941-1942	numri tregues 1941 - 1942 baza (1937-38=100)
	Pesha në kg.		
miell gruri	38.6	62.9	163,8
miell misëri	116.2	110.1	97.4
verë	5.8	26.8	462
oris	3.2	4.8	150
patate	2.5	6.8	272
fasule	2.6	3.5	134.6
tlynë	1.1	1.3	118.1
vaj	5.3	2.9	54.7
qumësht	5.6	6.4	114.2
djathë	2.1	3.5	166.6
sheqer	4.1	5.3	129.2
kafe	0.5	0.2	40
birrë	0.2	1.6	800
alkool	0.04	1	2500

BKSH

BKSH

LIDHJE E.F.

BKSH

BKSH

TREGU MONETAR





BKSH

QARKULLIM DHE POPULLATE



QARKULLIM

DATA	QARKULLIM absolut në miliona franga	QARKULLIM procapita në franga	Numrra tregues bazë mars 1939 = 100 qark. absolut	Numrra tregues bazë mars 1939 = 100 qark. procapita
31 - XII - 38	12.500	11.2	90.5	90.5
" - III - 39	13.800	12.3	100	100
" - XII - "	29.800	26.6	216.2	216.2
" - X - 40	62.500	55.8	453.6	453.6
" - XII - "	80.179	71.7	582.9	582.9
" - IV - 41	140.000	72.8	1014.4	591.8
" - XII - "	108.761	56.5	783.1	459.3
" - " - 42	141.897	73.8	1028.2	600
" - V - 43	155.295	80.7	1125.3	656
" - VII - "	182.915	95.1	1325.4	773.1

BKSH

BKSH

QARKULLIM DHE DERGESA TE HOLLASH



BKSH

BKSH

QARKULLIMI DHE ÇMIMET



BKSH

BKSH

NUMRA TREGUES TË QARKULLIMIT DHE TË ÇMIMIT TË JETESËS.



BKSH

BKSH

DËRGESA FONDESH PREJ ITALIE NË SHQIPËRI ME ANË TË BANKËS KOMBËTARE TË SHQIPNIS

DATA	VLEFTAT ABSOLUTE	MESATARE MUAJORE	VLEFTAT PROGRESIVE
	në miliona Fr. shq.		
prill 1939 – tetor 1940	321.1	16.9	321.1
nandor 1940 – prill 1941	418.8	69.8	739.9
maj 1941 – janar 1942	384.3	42.7	1.124.2
shkurt 1942 – dhjetor 1942	390.4	35.4	1.514.6
janar 1943 – gusht 1943	177.6	22.2	1.692.2
Shuma	1.692.2	31.9	1.692.2

BIGSH

BKSH

DERGESA TE HOLASH NGA ITALIA





BKSH

BKSH

DISPONIBILITETE KREDINA
QARKULLIM DHE DETYRIME TË TJERA



BKSH

BKSH

BKSH

BKSH